

# RREGULLORE PËR PËRZGJEDHJEN E TRAJNERËVE TË EKIPIT KOMBËTAR TË FEDERATËS SHQIPTARE TË BILARDOS NË SNOOKERIT

## Neni 1: Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen e trajnerëve të ekipit kombëtar të bilardos në snookerit, duke siguruar që vetëm trajnerët e kualifikuar dhe me përvojë të jenë të angazhuar në zhvillimin e ekipit.

## Neni 2: Kriteret e Kualifikimit

Për të qenë kandidat për trajner të ekipit kombëtar të bilardos në snookerit, individët duhet të plotësojnë një nga këto kritere:

### 2.1. Tituj Akademikë

- Të kenë një titull të lartë (minimum master) në fushat e sporteve, edukimit fizik, ose ndonjë disiplinë tjetër relevante ose vlerësime nga institucione shtetërore.

### 2.2. Certifikata Trajnimi

- Të kenë një certifikatë trajnimi të njohur nga Federata Evropiane (EBSA, EPBF) ose nga Federata Botërore e Bilardos (WPA, IBSF, WSF) në fushën e bilardos dhe snookerit.

## Neni 3: Procedura e Përzgjedhjes

### 3.1. Kërkesa për Aplikim

- Të gjithë kandidatët duhet të dorëzojnë një kërkesë për aplikim në federatë, e cila përfshin:

- CV e plotë
- Kopje e certifikatave përkatëse ose titujve të marrë
- Referenca nga organizata të tjera sportive, nëse është e aplikueshme.

### 3.2. Vlerësimi i Aplikimeve

- Një komision i ngritur nga federata do të shqyrtojë të gjitha aplikimet në përputhje me kriteret e lartpërmendura dhe do të përzgjedhë kandidatët që do të intervistohen.

### **3.3. Intervista**

- Kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për një intervistë, e cila do të vlerësojë njohuritë e tyre për bilardon, snookerin, karambolin, strategjitë e trajningut dhe vizionin për zhvillimin e ekipit kombëtar.

### **3.4. Vlerësimi Përfundimtar**

- Pas intervistimit, komisioni do të bëjë një vlerësim të fundit dhe do të rekomandojë trajnerët për t'u emëruar nga Këshilli Drejtues.

### **Neni 4: Periudha e Emërimit**

Trajnerët do të emërohen për një periudhë të caktuar, e cila mund të rinovohet në përputhje me performancën dhe rezultatet e ekipit Kombëtar.

### **Neni 5: Detyrat e Trajnerëve**

Trajnerët e emëruar do të kenë përgjegjësinë për:

1. Zhvillimin dhe implementimin e strategjive të trajnimit.
2. Organizimin e seancave të trajnimit dhe përgatitjen e ekipit kombëtar për kompeticione.
3. Bashkëpunimin me federatën për të siguruar mbështetje dhe resurse të nevojshme.

### **Neni 6: Disiplinimi**

Trajnerët do të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre dhe do të jenë subjekt i procedurave disiplinore në rast të shkeljeve të rregullave ose standardeve të etikës së sportit.

### **Neni 7: Modifikimi i Rregullores**

Kjo rregullore mund të modifikohet vetëm me miratimin e Këshillit Drejtues të Federatës Shqiptare të Bilardos.

### **Neni 8: Fuqia e Rregullores**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Federatës Shqiptare të Bilardos dhe Snookerit.

